



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:092025

Datë: 17.11.2022

Numri i dokumentit: 03659904

P. nr.336/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.S nga Gjakova, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par. 3 lidhur par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II nr. **517/22** të dt.16.08.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **17.11.2022**, në prani të Prokurorit të shtetit Qazim Xharra, të dëmtuarit S.B, mbrojtësit të akuzuarit av. Meshari Selimaj si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.S**, nga Gjakova, Rr "...“ nr. ..., data e lindjes..., në Gjakovë, i ati ... dhe nëna ... e vajzërisë ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar atë i 1 fëmijë, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, me ID ...

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse :

-me dt.23.03.2022 në ora 17:35 min, në rr. "...“ në Gjakovë, pikërisht në gjimnazin “Hajdar Dushi”, i pandehuri përmes telefonit me dashje kanos seriozisht me fjalë, vepra apo gjeste se do të shkaktoj ndonjë të keqe personit zyrtar dhe atë mësimdhënësit të djalit të tij, të dëmtuarit S.B, në atë mënyrë që ditën kritike përmes telefonit i dëmtuari e kishte njoftuar të pandehurin se djalit të tij i’ a kishin marr telefonin pasi e kishte përdorur në orë të mësimit dhe sipas rregullores së shkollës nxënësit i mirët telefoni dhe i dorëzohet prindit, pas këtij njoftimi i pandehuri revoltohet dhe i drejtohet të dëmtuarit me fjalët “*Kush jeni ju a jeni prokuror a çka jeni*”, “*ti shkërdhefsha robt, a e din se vi atje e ju mbys, jau shkërdhej robt një nga një*”, me ç’ rast të dëmtuarit shkakton frikë dhe ankth për jetën e tij.

-me çka ka kryer veprën penale kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49,69, 70,71, 72 par .1 nën.par.1,6, neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditë**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I dëmtuari S.B nga fsh. ... Komuna - Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej 30.00 €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20.00 €, në afat prej 15 ditëve, pasi Aktgjykimi të marrë formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II nr. **517/22** të dt.16.08.2022, e ka akuzuar të akuzuarin A.S nga Gjakova, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 17.11.2022, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë, Prokurori i shtetit Qazim Xharra, lexon aktakuzën, PP/II nr. **517/22** të dt.16.08.2022, me ç'rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari A.S, gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Meshari Selimaj, deklaroi se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, duke i ditur edhe me parë pasojat dhe favorët juridike të pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam përdorur për veprën e kryer në afekt, menjëherë pas bisedës së bërë në telefon e kam ftuar dhe i kam kërkuar falje për veprimet e mia ku edhe sot publikisht i kërkoj falje të dëmtuarit për veprime të mia, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jem me kujdes të mëtejshëm, me të dëmtuarin me parë apo pas këtij rasti nuk kemi pasur asnjë mosmarrëveshje, andaj i propozoi gjykatës që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, kërkim falje nga i dëmtuari, fakti se me parë nuk kam rënë ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Meshari Selimaj deklaroi se pranimi i fajësisë i bërë nga ana e të akuzuarit është i vullnetshëm dhe në përputhje me gjendjen faktike që tregon aktakuza, i pandehuri i kupton pasojat dhe favorët e pranimin të fajësisë, ashtu që e kërkojmë gjykatës që të aprovojë këtë pranim të fajësisë. Po që se gjykata bënë pranimin e fajësisë kërkojmë nga e njëjta që të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që e karakterizojnë këtë rast, e gjegjësisht pranimin i fajësisë edhe në fazat e mëtejshme, pranimin e fajësisë në shqyrtimin e sotëm gjyqësor, faktin se pas kryerjes së veprës penale i pandehuri menjëherë ka kërkuar falje të dëmtuarit edhe sot i kërkon falje atij dhe pendohet thellë për veprimin e bërë, faktin se i pandehuri asnjëherë me parë nuk ka kryer veprë penale, karakteristikat e tij personale si familjar, i martuar dhe babai një fëmijë, fakti se është edhe i pa punë, gjitha këto rrethana mendojmë se përbejnë mundësinë se kjo gjykatë të shqiptojë një dënim me të butë ndaj të pandehurit.

I dëmtuari S.B deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi me qene se me të njëjtin as para e as pas këtij rasti nuk kemi pasur probleme.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Qazim Xharra deklaroi se duke pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas dispozitivit të aktakuzës PP/II,

517/22 të dt.16.08.2022 dhe e se i njëjti paraprakisht ka kuptuar natyrën, pasojat dhe favoret e parimit të fajit , një pranim i tillë u bë vullnetarisht pas sqarimit të mjaftueshëm nga mbrojtësi i tij av. Meshari Selimaj , po ashtu edhe nga ana e gjykatës, po ashtu faktin se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes respektivisht provave materiale dhe personale që përmban aktakuza, në bazë të cilave edhe është paraqitur gjendja faktike si në dispozitivin ku edhe përmbushen elementet e veprës penale për të cilën ngarkohet , po ashtu edhe fakti se aktakuza është e ligjshme dhe se provat të cilat i përmban është provë e nxjerra në bazë të rregullave të përgjithshme mbi provat , andaj prokurori i shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit. Gjykatës i propozoi që të akuzuarin të shpall fajtor të i shqiptojë një dënim të paraparë me ligj, duke pasur parasysh shkallen e përgjegjësish dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet . Gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit e llojit dhe lartësisë së dënimit të këtij parasysh edhe qëllimin e dënimit duke i vlerësuar rrethanat lehtësuese e si dhe ato rënduese

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A.S: **-me dt.23.03.2022 në ora 17:35 min, në rr. “...” në Gjakovë, pikërisht në ...”**, i pandehuri përmes telefonit me dashje kanos seriozisht me fjalë, vepra apo gjeste se do të shkaktoj ndonjë të keqe personit zyrtar dhe atë mësimdhënësit të djalit të tij, të dëmtuarit S.B, në atë mënyrë që ditën kritike përmes telefonit i dëmtuari e kishte njoftuar të pandehurin se djalit të tij i’ka kishin marr telefonin pasi e kishte përdorur në orë të mësimin dhe sipas rregullores së shkollës nxënësit i mirë telefonin dhe i dorëzohet prindit, pas këtij njoftimi i pandehuri revoltohet dhe i drejtohet të dëmtuarit me fjalët **“Kush jeni ju a jeni prokuror a çka jeni”, “ti shkërdhej robt, a e din se vi atje e ju mbys, jau shkërdhej robt një nga një”**, me ç’rast të dëmtuarit i shkakton frikë dhe ankth për jetën e tij. **-me çka ka kryer veprën penale kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitivin të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e matjes së dënimit , gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitivin të këtij Aktgjykimi , ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është baba i një fëmije , sjelljen e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte , me shqyrtim të mesëm dhe asnjëherë më parë nuk ka rëndësuar me ligjin , nuk ka qenë i dënuar . Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personalitetin e tij, që të gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm , korrekt, i urtë dhe i vetëdijshëm për pasojat e shkaktoara, është penduar thellë për veprën penale . Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , pendimi shprehur për veprën e kryer, kërkim falje nga i dëmtuari deklarimi i të dëmtuarit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi , të cilat rrethana ndikuan që Gjykata të zbatoj dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara në nenin 72 par.1 nën.par.1.6 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit i shqiptojë dënim me burgim në minimumin e paraparë ligjor dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale ,me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimin e shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit..

Gjykata, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin S.B , për realizimin e kërkesës pasurore juridike ti udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë, të kërkesës pasurore juridike edhe pse i dëmtuari gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike.

Vendimi mbi shpenzimet paushallit gjyqësor në shumë prej 20 .oo €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së, dhe shpenzimet në shumë prej 30.oo € për kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.336/22 datë 17.11.2022.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatë së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate